

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

SHABAN QESARAKU

ANALIZË ESTETIKE E RRËFENJËS *E MADHE ËSHTË GJËMA* *E MËKATIT* E MITRUSH KUTELIT

Çdo vepër letrare të jep mundësinë për ta interpretuar atë me një ose disa metoda të kritikës letrare. Në këndvështrimin tim, mendoj se metodat letrare janë një kontribut në atë se çfarë ato sjellin në lidhje me veprën letrare, për stilistikën, retorikën, vlerat estetike, personazhet, për formën me të cilën bëhet komunikimi e për gjithçka tjetër. Përpyekja për të analizuar një vepër letrare duke përdorur njërin apo disa (metoda), kushtëzohet nga shumë faktorë. Do të mundohem që nëpërmjet tekstit të “E madhe gjëma e mëkatit” dhe autorit të saj Mitrush Kuteli të bëj një interpretim të veprës, të mesazhit të saj, duke alternuar elemente të njëjës, apo tjetrës metodë, sa të pozitivizmit, aq dhe të psikanalitikës, të formalizmit e më tej.

Në qëllimin e kësaj pune me shkrim, përveç faktit të interpretimit të veprës me një apo disa metoda kritike, të ndërthurura shpeshherë me njëra - tjetrën, përzgjedhja e kësaj pjese nuk është rastësore. Kjo ka të bëjë me kontributin, ose siç përdoret shpesh sot, me prurjen në fushën e letërsisë të atyre vlerave të përhershme, të sendërtuara në veprat, në rrëfenjat. Ato janë të rralla, pasi dhe njerëzit që i krijojnë këto vlera janë me cilësi të veçanta, me një status ndryshe nga të tjerët, status që ua jep produkti intelektual i tyre. Mitrush Kuteli është njëri nga ata.

Historia e letërsisë shqipe nuk mund të kuptohej pa rrëfenjat e Kutelit. Ato, si një margaritar me ngjyrë të veçantë, shkëlqejnë, duke rrezatuar dritën e tyre e duke mos e humbur asnjëherë atë. Ato janë të shumta, me tematika nga më të larmishmet, me personazhe, psikologji, kode, botë shpirtërore e fizike, me ndjenja që përplasen mes tyre, të afërta e të largëta njëkohësisht. Nga ky thesar përzgjedhëm njërin prej tyre, por mund të zgjidhnim cilëndo tjetër, pasi ato kanë të njëjtë vlerë: sipëroren. E përzgjedhura jonë na josh për mënyrën e veçantë të trajtimit të ndjenjës së dashurisë, të ndërlidhjes së saj me fantastikën. Kjo është pikërisht rrëfenja “E madhe është gjëma e mëkatit”.

Në përpjekjen tonë do të bëjmë një analizë të vetë titullit të veprës, zberthimin e intrigës kryesore ta saj, mëkatit, kryefjala e gjithë rrëfenjës, të lidhjes së filozofisë me letraren dhe anasjelltas. Pjesë e trajtimit të veprës do të jetë argumentimi për mënyrën e të lexuarit të saj, të raporteve dhe mënyrës së funksionalizimit të personazheve, të sendeve, të kohës dhe konvencionit të saj, të stilit dhe vlerës së përhershme të veprës, si një realizim i pritjes estetike.

“E madhe është gjëma e mëkatit”. Një titull që parathotë se do të ndodhë diçka, por ajo që do të ndodhë do të shfaqet me një formë të re, jo si gojëdhënë, por në formën e një proze moderne. Titulli i novelës është një ftesë e thënë në mënyrën më të thjeshtë, një joshje e cila na fut në brendësinë e zhvillimit të

ngjarjeve, me një stil të veçantë të të rrëfyerit, duke na shpalosur një histori dy mijë vjeçare të jetës njerëzore, të jetës shqiptare. Ajo është në vetvete mbartëse e mesazhit, e kumtit që autori na e thotë qysh në fillim. Atmosfera mistike-historike zbulon raportin e qenies njerëzore, e individit me zotin dhe me veten. Ky raport është në vetvete një konflikt midis “unit” real dhe “unit” mistik të personazhit. Ai, në thelb, përfaqëson konfliktin midis dy filozofive: asaj të materies dhe idealees. Gjithë struktura e veprës ndërtohet mbi këtë konflikt, duke nxjerrë në pah një nga temat bashkëshoqëruese të historisë së njerëzimit: raportin midis trupit e shpirtit. Në këtë këndvështrim, kjo prozë i kapërcen kufijtë e lexuesve të gjuhës origjinale për ta kthyer atë në një dëshmi elitare të artit shqiptar.

Nëse i referohemi studimeve për Kutelin¹, apo vetë thëniet e tij në lidhje me vërtetësinë e ngjarjeve në krijimet e tij, të cilat ia kanë rrëfyer pleq të moçëm e të mençur, ai vetë, si askush tjetër arin t’i tregojë ato në një mënyrë origjinale me një stil të vetin², duke i bërë ngjarjet më dramatike se sa do të ishin, por pa u shkëputur asnjëherë të vetme nga mënyra tregimtare e tyre. Kalimet lakonike të mënyrës së të rrëfyerit, nga përdorimi i vetës së tretë në vetën e dytë, ose në vetën e parë shumës, e bën shkrimtarin, jo vetëm të dashur si një këngëtar të mrekullueshëm me një zë të ngrohtë e të vërtetë, sa popullor po aq klasik dhe modern, një këngëtar lirik që di të këndojë në të gjitha rrymat e muzikës, por brenda së njëjtës këngë dhe ajo që është më e rëndësishmja, në mënyrë aq të përsosur.

Mëkati, rruga drejt tij.

Autori na ka paraqitur një vepër, në të cilën situatat rrjedhin natyrshëm dhe në harmoni me ngarkesën psikologjike të personazhit kryesor. E gjithë ngjarja, zhvillimi i saj është konceptuar në mënyrë të tillë që të kenë të pranishme ndërjegjen dhe arsyetimin në çdo veprim të ndërmarrë. Prania e gjithçkaje në vepër është funksionale: Personazhi kryesor, Tat Tanushi, është i plotësuar në mënyrën sipërore të mundshme, me të gjithë elementet për t’u përballur në konfliktin me vetë Zotin. Ai do të ndeshet me të pa kompleksin më të vogël të tërheqjes, i gatshëm për të pritur dënimin e tij dhe për ta përballuar atë me një qëndresë të jashtëzakonshme. Funksionale është dhe zgjedhja që ka bërë autori duke i vendosur ngjarjet dhe personazhin kryesor nga “një katund i math, jo shumë lark nga deti”³. Elementët gjeografikë, historikë dhe etnopsikologjikë, harmonizohen me synimin për të arritur një përfaqësim të shkallës më të lartë të personazhit.

Tat Tanushi i Bubutimës, përfaqëson karakteristikat më origjinale të vendit nga i cili rrjedh, të banorit të trevës së Shqipërisë së Mesme, të burrit me një karakter të veçantë, të marrëdhëniet e tij, duke përfshirë dhe dashurinë ndaj femrës. Autori e vendos këtë personazh përballë zotit, në një ndeshje biblike. Shohim që ndikimet biblike (Libri i Jobit, Kënga e Këngëve), si një rebelim i

¹ N. Ismajli, *Një prozë religjioze*, Revista “Drini” 23.10.2011.

² M. Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit* (Tat Tanushi i Bubullimës).

³ Po aty. f. 13.

Analizë estetike e rrëfenjës *E madhe është gjëma e mëkatit...*

njeriut ndaj perëndisë, janë të pranishme te autori, të mishëruara në personazhin e vet. Përballja e personazhit është e shprehur me mërinë për vdekjen e Kalijes. Ecja e tij e vetëdijshme drejt mëkatit dhe përpjekja për t'iu kundërvënë dënimit të Zotit, tregojnë forcën e madhe të dashurisë, karakterin e paepur, i cili, në kompleksin e trashëgimisë fisnore dhe në kontakt me zhvillimin e tij human, përbën "unin" real të individit⁴. Ky "un(i)", përbën nga njëra anë forcën kryesore të konfliktit të novelës, anën tjetër të saj e përbën "uni" mistik fetar, i cili, te Tata, është gjithashtu një formim i vetëdijshëm për shkak të detyrës së priftërisë dhe besimit në Zot. Në përballjen mes të dy "unë" - ve, Kuteli bëhet aq i vëmendshëm sa të mahnit me filozofinë, argumentin dhe përgjegjësinë e përbashkët të tyre.

Personazhi është ndërtuar në funksion të qëllimit. Referuar raporteve njerëzore e fetare, ky personazh e ka të qartë pozitën e tij. Ai jeton i lumtur me gruan që do dhe e vlerëson këtë gjë. Në punën si fetar, ai është një shërbëtor i përkushtuar i fesë. Ai shfaqet i plotë në të dy raportet. Të dy "unet" në vetëdijen e Tatës janë të përputhur në mënyrë të harmonishme. Ata funksionojnë në unitet të plotë, sipas nevojave më imediate të qenies humane dhe fetare. Në një analizë më specifike, do të vërejmë se funksionon më së miri vetëm raporti i çiftit, Tatë - Kalie. Nga ngarkesa me të cilën shfaqet ndjenja e dashurisë, sidomos e Tatës për të shoqen, vërejmë se pesha specifike e "unit" real është më e madhe se ajo e "unit" mistik. Mjafton të zbulojmë shtresëzime të tilla, për të arritur në konkluzionin se leximi i brendshëm ka realitete të fshehura nën një simbolikë komplekse të vetë tekstit.

Ajo që duket se rrjedh natyrshëm nuk është gjë tjetër veçse dora mjeshtërore e autorit. Si një dirigjent me përvojë ai e drejton orkestrën dalëngadalë drejt një finaleje të madhe. Ai di të ndërtojë, pasi e ka të qartë qëllimin final. Në momentin që personazhi kryesor përjeton shëndetin dhe çastet më të mira të kënaqësisë njerëzore, vëren se diçka nuk shkon, sidomos në këtë moment kur lumturia është në shkallën më të lartë. Shenja e parë është kur i sëmuret e shoqja. "Uni" i tij nuk mund të qëndrojë në pozita të tilla triumfuese. Vlerësojmë tri momente, të cilat janë sinjalet e para të ndëshkimit ndaj tij. E para është përgjigjja ndaj së shoqes: "*Që të të shoh më mirë, zemra ime*"⁵. E dyta kur i lutet Zotit, "*Merr vite nga vitet që më ke dhënë dhe jepja shërbëtores tënde Kali që të lavdërohet emri yt përjetë*"⁶. Dhe e treta kur, "*Nga dhimbja e madhe mjekra e flokët e tij u zbardhë krejt, sa dukej plak i shkuar dhe jo njeri më tridhjetë e shtatë*"⁷. Fillon të funksionojë raporti tresh: Tat - Kalie - Zot. Në këtë pjesë të novelës shohim të realizuar nga autori himnin e vërtetë për dashurinë njerëzore, nëpërmjet një gjuhe figurative aq të pasur, aq të kursyer e aq të thelluar. Himni i dashurisë nuk shkruhet me fjalë, por me sende dhe objekte, me lëvizje kurmi dhe shpirti. Leksiku kutelian në përshkrimin e himnit të dashurisë rrjedh furishëm. Ai përbëhet nga

⁴ N. Plaku, www.gazetakritika.net/Forumi/lettersi

⁵ M. Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit*, f. 22.

⁶ Po aty, f. 27.

⁷ Po aty, f. 28.

fjalë të tilla si: Puthje, frymë, hije, vdekje, buzë, re etj., të cilat me kombinimin e sintaksës poetike kuteliane realizojnë perla të vërteta.

Personazhi ynë nuk do të rrijë në një gjendje statike. Lëvizja tek ai është një proces mendor. Do ta shohim këtë te “tronditja” e ‘unit” mistik të trinomit të sipërpërmendur. Sintaksa e përdorur nga autori do të përfshijë elemente të një gjendjeje transhedente me skena të ëndrrave, engjëj, zëra në mur, vizione ezoterike, e gjitha një ankh e tmerr apokaliptik.

Tat Tanushi fillon të zhvillohet në një qasje të re, atë të marrëdhënies me mëkat. Shfaqja e kësaj marrëdhënieje është rebelimi i tij në periudhën e mbajtjes së zisë për të shoqen. Janë edhe këtu tri momente kryesore, që kulmojnë këtë revoltë, të cilat kanë një diagramë me tendencë rritjeje. (Nuk është i çuditshëm fakti që Kuteli shpeshherë përdor numrin tre, si numri i shenjtë i trinitetit të krishterë) 1. Dëshira e tij për t’u futur në varr. “*Tat Tanush, Tat Tanush - i thirri një zë së larti, - Përse e zemëron Zotë me dhimbjen tënde?*”⁸ Ky ishte mëkat i madh dhe si mëkat iu shkrua në librin e jetës. 2. Mendimi i tij se porta e varrit është porta që hyn në botën e përtejme dhe Zoti i drejtohet: “*Lëre dhimbjen tënde dhe ruaj kopenë time*”⁹. Dhe ia shkruan mëkatit e dytë në librin e jetës. 3. Dëshira për hapjen e varrit. “*Dikur, nga malli, i shkau mëndja t’i hapë varrë që ta shëkojë edhe një herë. Këtë nuk e bëri me dorë, por e kreu me mendje edhe kaq mjaftonte sa t’i shkruhej si mëkat i rëndë*”¹⁰. Është faza kur “uni” mistik është tronditur së tepërmi. Zoti ende nuk po e ndalon dot bariun e tij të mos shkojë në rrugën e mëtejshme të mëkatit.

Për njeriun ruajtja e shpirtit nga mëkatet është frika ndaj perëndisë dhe ligjeve. Kjo gjë do të vlente dhe për Tat Tanushin, por ai në këtë fazë i ka përjashtuar që të dyja. Shpjegimi gjendet në dhimbjen që ai vetë po përjeton, në shenjtërimin e dashurisë, në mospranimin e vdekjes si proces njerëzor dhe kundërvënien e tij ndaj fatit të verbër të perëndive. Ngarkesa emocionale e psikologjike e personazhit merr një kurbë rritëse pikërisht në këtë moment, kur Kuteli i shton atij edhe me një tjetër mëkat, skulpturimin e fytyrës së Kalijes në dru. Sipas konceptit fetar, të atij që përfaqësonte Tat Tanushi, punimet në dru janë për shenjtorët, jo për vdekatarët. “*Kaluan kështu tre vjet dhe në këta tre vjet ay u largua nga i Madhi i jetës, për një dorë eshtra e për fytyra të bëra në dru. Emri dhe fjalët e Zotit ishin edhe tani në buzët e tij, po zemra lark - sepse mbante mëri*”¹¹.

Tashmë ai kalon nga njëri mëkat në tjetrin: nuk respekton rregullin që një burrë i ve duhet të mbajë “*kreshmë syri*” në respekt të të ndjerës, si dhe rregullin priftëror atë privimit të kënaqësisë seksuale të njeriut, pra pjesë e “unit” mistik për

⁸ Po aty, f. 28.

⁹ Po aty, f. 29.

¹⁰ Po aty, f. 29.

¹¹ M. Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit*, f. 30.

Analizë estetike e rrëfenjës *E madhe është gjëma e mëkatit...*

shkak të detyrës. “Dhe ligji i hirit nuk e lejonte të dashurojë e të marrë grua të dytë.”¹²”

Po t'i referohemi raportit të mëparshëm Tatë - Kalie - Zot, shohim se kemi një ndryshim të dukshëm. Kalija që me vdekjen e saj, shkaktoi mërinë e Tatës ndaj Zotit, zëvendësohet me imazhin e një gruaje të munguar, e cila rizgjon me ardhjen e saj mërinë e Zotit ndaj Tatës. Periudha e Kalies ka mbaruar. “Dhe kur pluhuri mbulonte të gëdhendurat me fytyrën e Kalijes, trupi i tij kërkonte trup, me egërsinë e përrenjve që s' shohën ku zbresën. Filloj tani të dëshirojë fatin e Jakovit që kish shumë gra e shumë shërbëtore për dëshirat e tij”¹³”.

Sulmi hakmarrës i Tatës ndaj Zotit vazhdon tani, jo për hir të Kalies, por për hir të lumturisë që atij i mungon. ‘Uni’ mistik religjionar fillon tashmë të tronditet për shkak të lirisë së individit përfaqësuar nga ‘uni’ ekzistencial. Pikërisht këtu shfaqet vlera kryesore e kësaj vepre: lufta për lirinë e individit me forcën më madhore të përfytyruar.

“Ideja e mendimit abstrakt” e trupëzuar në detyrën e shërbëtorit të perëndisë (priftit), zbehet përpara dëshirës njerëzore në prekjen reale të mishit të bardhë, duke u kthyer në një makth konkret që e zbeh abstrakten. Të mos harrojmë që autori e ndriçon personazhin e tij në konfliktin që ka me Zotin, duke e ndërgjegjësuar atë për veprimin që kryen, duke e frymëzuar me moralin e “shkronjës” së Solomonit. Në këtë mënyrë trajtimi që bën autori edhe pse duket që “uni” mistik ka një vlerësim, duhet thënë se përfitues bëhet “uni” real, duke u bërë më i plotë e më i kompletuar në përballjen me “unin” mistik. Tashmë të dy këta “unë” ndeshen të bazuar mbi argumente teorike, që përfaqësojnë dy filozofi të kundërta në historinë e njerëzimit: materialen dhe idealen. Në momentin që Tat Tanushi shkrimeve të shenjta u jepte kuptimin e mishit dhe jo të frymës (shpirtit), bindemi që ai është i ndërgjegjshëm për mëkatit e tij. Kulmi arrin me “shembjen e madhe: trupi i tij njohu trup gruaje...kreu mëkatit e math të mishit”¹⁴”. “uni” real përfundimisht ka fituar mbi “unin” mistik. Udhë e Tatës drejt mëkatit këtu përfundon. Tashmë ai ndodhet përpara derës së tij dhe nga çasti në çast bëhet gati të hyjë brenda.

Përballja

Hakmarrja e Zotit për mërinë e krijuar nga Tat Tanushi ka filluar. Tashmë më shumë se kurrë, vetë autori nuk mund ta braktisë personazhin, i cili është plotësisht produkti më i mirë i tij. Karakterin burror, të cilin ia ka veshur personazhit edhe tani nuk ia heq. Ai (personazhi) nuk heq dorë nga “uni” ekzistencial. Është shpërfillës në veprimet e tij, sidomos në kundërvënien ndaj rregullores së priftërisë duke shkuar në meshë pa u rëfyer. Kjo vërteton faktin se atij nuk i ka mbetur asgjë nga “uni” mistik. Kjo gjë nënkupton idenë e shpërfilljes së skolastikës kishtarë dhe rregullat kanonike të saj. Vetë jeta me çdo gjë të sajën bëhen tek Tat Tanushi synimi absolut i qënies së vet. I bindur në këtë gjë ai do të

¹² Po aty, f. 31.

¹³ Po aty, f. 32.

¹⁴ M. Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit*, f. 37.

dalë në duel përballë Zotit: “Për tri të thëna që tha, tri përgjigje dëgjoj nga muri i faltores. Edhe si ish i shpejtë në zemërim - si kanë qenë e janë të gjithë ilirianët, edhe atëhere kur kanë hirin e Zotit - thirri me zë të vrazhët: Aty mbeç! Dhe zëri ia ktheu: - Kurrë mos vdekç!¹⁵”

Është çasti më kulmor i pjesës me një ngarkesë psikologjike të jashtëzakonshme. Fraza e mallkimit, e shkurtër për nga ndërtimi, mbart në vetvete një tingëllim të veçantë e përftuar nga aliteracioni me qëllim rritjen e fuqisë shprehëse dhe ç’është më e rëndësishmja ajo që shpreh kjo formë, përmbajtjen e saj¹⁶.

Hakmarrja është bërë në pikën më të dobët të një vdekëtari: në zhdukjen e gjurmëve të Kalies dhe në shkëlqimin e argjendit të gruas së qytetit. “I vetmi send që shkëlqente në një botë të murme¹⁷”.

Shpëtimi nga mëkati

Mallkimi i Zotit ka ngjyrë të murrme. Me të vetmin shkëlqim në atë botë mallkimi: argjendi i gruas nga qyteti. Pa Kalijen si kujtim. Asgjë tjetër. Jeta e mëvonshme e Tat Tanushit do të jetë apokaliptike. “Uni” real i tij është zhdukur duke u kthyer i gjithi në një “unë” mistik.. “Binte në ujëra e s’mbytej, hynte në zjarr e s’digjej, shkante nëpër luftë e s’vritej¹⁸”.

Në këto moment Tat Tanushit nuk i ka mbetur gjë tjetër, vetëm të presë. Të presë me shekuj vetëm për t’u falur nga Zoti. Falja, e cila zbulohet nga prift Nikanori, lidhet me elementin gjeografik të shenjtërimit. Kjo falje duhet të bëhet në Bubutimë, në rrënojat e kishës së vjetër, në varrin e përkultur të origjinës. Aty ku Kuteli bën edhe Zotin të kërkojë faljen e Tatës, duke vulosur përfundimisht faktin se lufta midis tyre ka qenë sa dinjitare aq edhe e vlerësuar prej të dyve.

Refleksione

Bazuar mbi vetë veprën, por dhe mbi trajtimin e tre pjesëve të mësipërme, ajo, vepra mund të lexohet në tri nivele: e para përshkruan dashurinë njerëzore, pjesa e dytë ka domethënie morale dhe përmbajtje biblike, ndërsa pjesa e tretë ndërtohet mbi një tekst simbolik dhe tregon zbulimin e shpëtimit. (treshi mistik) Me këtë vepër Kuteli ka krijuar modelin e njeriut të përsosur që gabon (gabim tragjik) për shkak të jetës. Pësimi i tij është një ushtrim shpirtëror për të arritur përsosmërinë deri në përjetësi. Tek pjesa e tretë kemi dhe një mister: Bashkimin dhe dëshirimin e njeriut për prehe. Edhe jeta e gjatë është vuajtje, jeta e gjatë është edhe mallkim (megjithëse ajo të jep mundësinë për t’u vetëpërsosur). Kështu, dëshirat dhe pasionet që pati ky prift shpeshherë kanë qenë në kundërshtim me raportet e njeriut si qenie. Arsyeya e prehes së shpirtit mban pezull dhe trajton gjithë idenë e veprës. Elementet iluministe i shohim kudo, sepse arsyeya, ndriçimi i mendjes të udhëheq ngado. Por Kuteli është dhe një shkrimtar që tërheq vëmendjen për elementin e theksuar kombëtar, për një imazh të gjallë

¹⁵ Po aty, f. 39.

¹⁶ A. Plasari, *Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve*, f. 75.

¹⁷ M. Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit*, f. 40.

¹⁸ M. Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit*, f. 42.

Analizë estetike e rrëfenjës *E madhe është gjëma e mëkatit...*

shqiptar. Prej këtej është përfutur universi letrar kutelian, me galerinë e tipave shqiptare, karakterin e tyre, me psikologjinë dhe mendësinë autentike.

Funksioni estetik i rrëfenjës “E madhe është gjëma e mëkatit” tek Kuteli mund të shihet që tek personazhet e tij. Ajo që duhet thënë qysh në fillim është fakti që autori e shikon njeriun si e vetmja krijesë racionale, i vetmi produkt që është i lidhur me emrin e zotit. Personazhet janë karaktere pak a shumë komplekse, fytyra që u japin jetë dhe interes fakteve të treguara, duke shkarkuar në këtë mënyrë pjesëmarrjen emocionale të lexuesit në ngjarjet e tyre. Siç e përmendëm edhe më lart në lidhje me protagonistin kryesor, ai është forma më e përkryer e realizuar që e ka të përcaktuar vendin e tij. Ai dallohet lehtë nga fytyrat dytësore që janë në raporte të caktuara në rrjedhën e rrëfimit. Fytyrat e veprës janë në lidhje me njëra-tjetrën, apo në konflikt dhe nga kjo marrëdhënie varet vetë zhvillimi i ngjarjes dhe përfundimi i saj. Ashtu si do të kryejë funksionin, i tillë do të jetë interesi dhe rëndësia e këtyre figurave që zhburohen më shumë në botën e tyre të brendshme, por dhe në aspektin e tyre fizik. Psikologjia e fytyrës veç përshtimit, mund të arrihet nga veprimet e tij, nga fjalët që thotë, nga mendimet që shoqërojnë zhvillimin e ngjarjeve dhe që autori ia paraqit lexuesit nëpërmjet fytyrës qendrore të Tat Tanushit.

Në lidhje me vështrimin estetik mbi sendet, vërejmë, se ky vështrim nuk është tangential, i sipërfaqshëm, i rastësishëm, empirik, por i drejtpërdrejtë. Tërheqja e Tat Tanushit prej sendeve, mëkatimi për hir të tyre është një nëntekst që do të thotë se mëkatimi vjen prej botës që e rrethon. Dhe bota që e rrethon janë njohjet, fenomenet, marrëdhëniet, raportet, traditat autoktone, gjithçka. Ndërhyrjet meditative të bëra nga autori janë një nga shprehjet në të cilën shohim se si realizohet, se si shkrihen ato në një të vetme. Këto ndërhyrje s’duhen quajtur si mosaftësi e përgjithësimit, por si një karakteristikë shumëfunktionale ndaj mjedisit që ai trajton. Ngjizja e tij estetike ka të bëjë me mohimin për të pohuar, prandaj kjo prozë mund të cilësohet me të drejtë si një nga perlat e prozës shqiptare, jo vetëm nga thurrja artistike, por edhe nga ideja dhe filozofia që e përshkruan atë.

Tek “E madhe është gjëma e mëkatit”, koha rrjedh në mënyrë “konvencionale”, por po në këtë pjesë autori e paralajmëron lexuesin për rrjedhën e panatyrshme të ngjarjeve, duke gjeneruar tek ëndrra që sheh Tat Tanushi i Bubutimës. Përpos paralajmërimit të kobshëm për vdekjen e Kalies, Tat Tanushi merr paralajmërimin se ai dhe koha do të ngrinin më pas: “Çdo gjë - drita, koha dhe ay vetë - kishin ngrirë si shtylla guri dhe nuk lëviznin më. Por zemra e tij kish jetë. Dhe jeta ish vuajtje¹⁹”. Gjëma e madhe e mëkatit ndihet edhe kur koha nuk ndjek më të njëjtën vijimësi. “Nga çasti i shembjes ditët u bënë javë, javët muaj, muajt vjete. Dhe vjetet u mblodhnë u bënë shekuj. Në kaqë gjëmë kohë u ngrehnë e u shembnë kështjella, u ngritnë e ranë pushtete, ardhë e shkuan breza. As faqja e tokës dhe as shtratet e ujrave nuk mbetnë të pandryshuar. Pyje u rritnë atje ku kishin qenë

¹⁹ M. Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit*, f. 26.

*katunde e katunde atje ku kishin qenë pyje*²⁰. Duket se koha është ngjeshur qëllimisht për të mos pasur zhvillimin horizontal, e për pasojë lëviz më shpejt, fluturimthi. Në tekst këtë shije estetike e nënvizojnë kuptimet antonimike “*u ngritnë dhe ranë kështjella, u ngritnë dhe ranë pushtete, ardhë e shkuan breza*”, si dhe ndryshimi i kuptimit të fjalëve nga kuptimi konvencional i tyre si p.sh.: “*ditët u bënë muaj dhe muajt u bënë vite*”. E gjithë kjo ëndje e tekstit i sugjeron lexuesit lëvizjen e pazakontë të kohës dhe pasojat e metamorfozës së natyrës. Kontrasti vendoset më poshtë: “*Sepse vetëm atë nuk e preku moti: mbeti i pandryshuar ashtu siç pat qenë ditën e meshës së fundit. Asnjë fije e bardhë nuk i ra nga kryet, asnjë rrudhë e re nuk i doli në fytyrë*²¹”.

Ndëshkim për të bëhet pandryshueshmëria, pavdekësia, ndëshkimi i tij, me fjalë të tjera bëhet koha. Ai mbeti gjallë për shekuj me radhë e nuk vdiste dot.

Mitrush Kuteli realizon një veper performance unike. Ai merr në konsideratë gjithë lëndën e veçantë të oratorisë popullore (rregullat e jetës kolektive dhe formulat e shprehjes), sigurisht, përmes një doze të lartë subjektiviteti. Këtë e bën përmes transformimit të zërit: ai shkruan duke folur vetë, më saktë flet duke shkruar dhe duket si një regjistrim i të folurit. Kuteli ka shqetësimin për të mos krijuar mospërputhje midis formës tingëllore (akustike) të ligjëritimit dhe asaj grafike (të shkruar). Si në të gjithë veprën ai realizon karakterin oral të saj në mënyrë shumë të qartë: “*...sepse ky (rrëfim) është i vërtetë dhe ka ardhur nga të lashtët, gojë më gojë. Dhe ne do ta shkruajmë në kartë ashtu si e kemi dëgjuar, për të dëshmuar me anën e tij ...*²²” Kuteli këtu është dhe transmetues dhe autor - rrëfimitar - dëshmitar - receptor.

Miti tek Kuteli na paraqitet me një formë të shkëlqyer të kulturës shpirtërore, specifike e kulturës primitive duke përfshirë një paraqitje të përgjithësuar të realitetit dhe një përpjekje për ta shpjeguar atë. Kjo formë kulturore, në mënyrë të zakonshme, huan aspektin e rrëfimit që popullohet me qenie dhe ngjarje përrallore që simbolizojnë lëndën dhe frymën etnike të kombit. Personazhi jeton për shekuj me radhë, e përcjell frymën ilire në trojet e veta, nën një peizazh me toponime autoktone dhe me një natyrë poetike arkitipale. Kështu edhe ligjërimi është funksional në transmetimin e lëndës mitiko-fetare. Duket sikur Kuteli përpos subjektit të shënuar përkatësisht me personazhin - prift, kërkon të shenjtërojë rrëfimin e tij, madje jo vetëm leksiku, por edhe sintaksa bëhet arkaike, ndërtuar sipas modeleve të ungjijve, duke fituar gjuhësisht karakterin historik dhe religjioz. Pranimi i botës mitike do të thotë të konfrontohesh me rendin hyjnor, që sundon mbi gjithçka që është njerëzore. Gjithandej na tërheqin vëmendjen studimet e antropologjisë kulturore ku njerëzorja me hyjnoren komunikojnë. Njeriu u drejtohet hyjnive përmes lutjesh, përmes sakrificash, përmes pjesëmarrjes në model, ndërsa hyjnia i adresohet njerëzores përmes ëndrrave, përmes shenjave paralajmëruese, përmes mrekullive. Në një kulturë mitike këto forma komunikimi

²⁰ Po aty, f. 41.

²¹ M. Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit*, f. 41.

²² Po aty, f. 11.

Analizë estetike e rrëfenjës *E madhe është gjëma e mëkatit...*

krijonjë përmasa të tjera të realitetit. Pothuajse gjithmonë qytetërimet janë të pushtuara, të mbytura me elemente infetare, mbinatyrare, magjike dhe ato jetojnë këtu gjithmonë. Frymëzojnë motivet estetikën më të fuqishme të psikikës.²³

Proza, endja e saj kap një trajtë të shenjtë, përmes arkaizmash përmes regjistrin të rrëfimit, poetikës dhe plasticitetit të frazës që krijon tek receptori ndjesinë e amshimit, përmes përshkrimesh, situatash e objektesh me ngarkesa fetare. Përshkrimi i Kutelit është i fuqishëm, karakterizues dhe i harmonishëm. Në përshkrimin e natyrës proza çuditërisht kthehet në poezi dhe dhjetëra faqe të tilla në rrëfimet e tij tingëllojnë si proza poetike të denja për çdo antologji. Pjesa e pandarë e prozës së tij është dialogu e monologu, të cilët së bashku në përshkrimin ndërtojnë veprën. Mënyra e thurjes së tyre, veçoritë gjuhësore përbëjnë edhe një nëntekst të heshtur, por që rrjedh pa artifice dhe që është në harmoni të plotë me komponentët e tregimit. Ai paraqet hyrjen misterioze, subjektin, kap fillin intrigues dhe bën përfundimisht zgjidhjen. Ekzistojnë marrëdhënie të brendshme mes heroit dhe lexuesit dhe janë këto të dyja që përcaktojnë karakterin dhe ndërtimin e veprës. Ndoshta thesari më i çmuar që na ka lënë Kuteli është gjuha e tij. Me të drejtë ai cilësohet si një nga mjeshtrat e letërsisë shqipe.²⁴ Ajo dallohet si një gjuhë e mbrujtur me jetë të gjallë e forcë të brendshme, me begati të madhe me ujë burimi dhe aromë mali. Ajo ka cilësi të larta ligjërimit artistik, jo vetëm nga leksiku i pasur, por edhe nga fryma ngjizëse analitike dhe sintetike. Vitaliteti i saj duket dhe nga pasuria figurative, muzikore, (nëse do ta quanim kështu), por dhe nga nuancat e holla stilistike. Ai krijoi një stil origjinal, sa lirik aq edhe epik, elegant me ngjyrimet poetike, i pasur me frazeologji dhe me nuanca natyrshmërie. Ai paraqitet i qetë, i shtruar, sa i rrjedhshëm aq edhe lakonik. Në të gjejmë sipas Kutelit "*Botën e vogël shqipëtare që pasqyron botën e madhe*". Në këtë botë sipas Kutelit, *jeton e mbijeton njeriu shqiptar*, të cilin shkrimtari e ka dhënë me fizionomi në një reliev të qartë, shpirtëror dhe fizik.

Nuk do të rrinim pa përmendur interpretimin e Aurel Plasarit²⁵, për analogjinë mes tekstit dhe jetës së autorit të goditur nga diktatura. Në këndvështrimin e tij shohim disa pika takimi, në lidhje me mëkatet, të cilat herë-herë janë bindëse dhe që përmendja e tyre nga ana jonë do të ish me interes.

Pikën e parë të takimit mes mëkatit të parë dhe autorit, Plasari, duke mos gjetur pikë tjetër lidhjeje mes vdekjes së të dashurës së personazhit dhe autorit në jetë, e gjen në vitin '44 në atë që ai e quan vit i "shembjes", si një lidhje me vetë krijimin. Pikat e tjera të përkimit kanë të bëjnë me moshën (40 vjeç), kohë kur autorit tonë i dështon përpjekja për të botuar vëllimin "Dashuria e barbarit Artan" dhe koha kur ka shkruar vetë veprën "E madhe është gjëma e mëkatit", e pasuar tri muaj më pas me arrestimin e tij dhe i dënuar si "armik i popullit". *Njësoj si Tata i novelës së tij, të cilit i është hequr e drejta e të meshuarit, pra të ungjillëzuarit, shkrimtarit i është hequr e drejta e fjalës. A thua që ai vegimtar i*

²³ F. Braudel, *Gramatica Civilzator*, 1994, f. 57.

²⁴ S. Hamiti, *Letersia Moderne Shqiptare*, f. 142.

²⁵ A. Plasari, *Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve*, f. 91.

pakorregjueshëm, i fshehtë nën emrin e rremë M. Kuteli, e paskësh tejkëqyrur edhe këtë akt të dramës së jetës së tij?

Çdokush ka të drejtën që me arsyetimet e tij, me lidhjet apo shtresëzimet në vetë tekstin letrar dhe në jetën e autorit të arrijë në interpretime të tilla. E bukura në letërsi qëndron në faktin se arritja në konkluzione të tilla është e pranueshme derisa nuk provohet e kundërta, çfarë përbën në një kuptim dhe dallimin mes veprave letrare dhe shkencave ekzakte.

“*E madhe është gjëma e mëkatit*”, është një prozë moderne jo vetëm sepse është mbështetur mbi një lëndë mitologjike, jo vetëm se trajtoi zonën e subkoshencës (nënvetëdija, instinkti), por edhe për imazhet, endjet e tekstit, asosacionet vizuale tronditëse me përkatësi nga letërsia surrealistë. Mitrush Kuteli e nderon mitologjinë, lashtësinë, historinë, gojëdhënën. Ai ruan madje të pandryshuar simbolet, konvencionet, besimin, poezinë, gjuhën, filozofinë popullore, të ruajtura prej mijëra vitesh në tokën ilire dhe që krijojnë hapësirat e jetës kombëtare. Rimarrja e lëndës mitologjike është një atribut i shkrimtarëve modernë. Përvetësimi i mitit e ka pikën mbështetëse tek e shenjta dhe kjo e fundit është imagjinuar si një vlerë dyfishe. Konflikti ndërmjet dy parimeve të kundërta përcakton edhe konfliktin e botës: qetësi-shqetësim, bukur-shëmтуar, jetë-vdekje, dashuri-urrejtje, të cilat janë antonimati i përhershëm i kësaj jete që vazhdon deri në pafundësi. Është kjo arsyeja që kjo vepër në atë çfarë jep, përjetohet prej lexuesit pavarësisht moshës, pavarësisht kohës, duke fituar universalitetin estetik.

BIBLIOGRAFI

- A. Plasari, *Kuteli midis të gjallëve dhe të vdekurve*.
F. Braudel, *Gramatica Civilzator*, 1994.
M. Kuteli, *E madhe është gjëma e mëkatit* (Tat Tanushi i Bubullimës) Bot. V.
N. Ismajli, *Një prozë religjioze*, Revista “Drini” 23.10.2011.
N. Plaku, www.gazetakritika.net/Forumi/letersi
S. Hamiti, *Letërsia moderne shqiptare*.